

KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- Në zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë)
- Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	075 388 783
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	075 388 752
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	077 983 887
Dibër	071 223 768
Delçevë	075 388 754
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 388 696
Kërçovë	045 225 172
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	075 388 749
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	031 415 799
Negotinë	075 388 718
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	076 261 309
Resnjë	070 481 001
Sveti Nikole	075 388 782
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	075 388 657
Veles	078 459 953
Shtip	032 392 147; 075 388 723
Karposh	075 388 747
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	
Shuto Orizari	

- Shoqatat e qytetarëve të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas

Emërtimi i shoqatës	Telefonat
Qendra kulturore për të rinj - Manastir	047 233 020; 071 254 337
SHMJR - Shkup	02 3 220 870; 072 223 963
Shoqata Qendra Kombëtare Rome - Kumanovë	031 427 558
EHO - Shtip	032 384 143; 070 228 282
MULTIKULTURA - Tetovë	044 377 775
"ZGJEDHJA" - Shtrumicë	075 495 470
Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë - Shkup	02 3 119 073; 02 3 290 469; 072 278 436
Shërbimi Jezuit për Refugjatë - Dega Maqedoni	02 3 237 299; 072 304 800
Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut - Shkup	02 3 243 331
"TË GJITHË PËR GJYKIM TË DREJTË"	02 6 139 874
HOPS - Shkup	02 3 246 205; 075 423 316
SFERA International - Manastir	074 245 154
Shoqata Forumi i Gruas - Tetovë	044 337 440; 044 343 410
"KHAM" - Dellçevë	071 215 356
Shoqata "Organizata për Gratë e Komunës së Shën Nikollë"	075 310 810

- Klinika juridike të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas

Emri	Telefonat
Fakulteti Juridik, UGD - Shtip	032 550 450; 032 550 477
Klinika Juridike "Qendra për Edukim Klinik Juridik në të Drejtën Penale", në kuadër të Fakultetit Juridik, UKIM - Shkup	02 3 117 244
Klinika Juridike "EMINE ZENDELI", Fakulteti Juridik pranë Universitetit të Evropës Juglindore - Tetovë	044 356 133
Klinika Juridike për Grupet e rrezikuara, e themeluar si qendër për klinikë juridike në kuadër të Fakultetit Juridik, UKIM - Shkup	02 3 226 023
Klinika juridike, Fakulteti Juridik, Universiteti Kolegji Amerikan - Shkup	02 2 463 159
Klinika Juridike, Fakultetit Juridik të Kërçovës, UKO - Manastir	045 220 267; 047 221 115
Klinika Juridike, Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik	077 761 999
Klinika juridike e Fakultetit Juridik pranë Universitetit të Tetovës	



Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

SQI

www.pravnapomos.mk

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

ÇFARË ËSHTË NDIHMA JURIDIKE FALAS?

Ndihma juridike falas lehtëson qasjen në drejtësi për personat të cilët, për shkak të gjendjes së tyre financiare, nuk janë në gjendje që t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre.

Ndihma juridike falas përfshin ndihmë juridike të financuar nga ana e shtetit si dhe lirim nga pagesa për procedura të caktuara.

Ndihma juridike falas është themeluar dhe rregulluar nga Ligji për ndihmë juridike falas nga viti 2019.

Ndihma juridike falas realizohet si ndihmë juridike primare dhe dytësore.

NDIHMË JURIDIKE PRIMARE

NDIHMJA JURIDIKE PRIMARE përfshin informim juridik, këshillim, udhëzim si dhe ndihmë gjatë plotësimit të formularëve dhe ankesave të caktuara.

Ndihmë juridike primare mund të shfrytëzohen të gjithë personat fizikë të cilët kanë vendbanim ose qëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ndihmë juridike primare ofrojnë zyrat rajonale të Ministrisë së drejtësisë, shoqatat e autorizuara dhe klinika të autorizuara juridike.

NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE

NDIHMJA JURIDIKE DYTËSORE i ofrohet personit i cili ka nevojë për ndihmë juridike profesionale nga një avokat për një çështje specifike juridike dhe i cili nuk është në gjendje të paguajë shpenzimet e procedurës për shkak të gjendjes së tij financiare dhe kërkesa e të cilit është e justifikuar.

Çfarë përfshin ndihma juridike dytësore?

- ndihmë juridike nga një avokat;
- lirim nga taksat gjyqësore dhe shpenzimet që lidhen me procedurat gjyqësore;
- lirim nga shpenzimet e ekspertizës;
- lirim nga taksat administrative;

Ndihma juridike dytësore nuk përfshin shpenzimet që shfrytëzuesi i ndihmës juridike falas është i detyruar t'i paguajë palës tjetër nëse dështon në procedurë.

Për cilat procedura mund të aprovohet ndihma juridike dytësore?

Ndihma juridike dytësore mund të aprovohet për përfaqësim në të gjitha nivelet në procedurat gjyqësore civile, procedurat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative. Çështjet ligjore mund të lidhen me pronën, punën, familjen, sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale përveç në fusha të caktuara që përjashtohen nga ndihma juridike falas.

Ndihma juridike dytësore nuk do të jepet për: çështjet doganore dhe tatimore; shpifje dhe fyerje; kompensim të dëmit jomaterial, përveç në rastet e viktimave të veprave penale, si dhe në rastet e vdekjes ose invaliditetit të rëndë; shkeljet; shërbime publike dhe komunale; dhe çështjet e pronës në procedurat administrative.

Kushtet për aprovimin e ndihmës juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore mund të aprovohet nëse:

- Të ardhurat mujore të kërkuarit i cili jeton vetëm, të mos tejkalojnë shumën e neto pagës minimale, ndërsa nëse jeton në një familje të përbashkët me anëtarët e familjes së tij të mos e kalojnë shumën e pagës minimale neto dhe të ardhurat mujore të çdo anëtari tjetër të familjes nuk e kalojnë shumën e 20% të neto pagës minimale
- Kërkuari dhe anëtarët e familjes së tij/saj kanë në pronësi vetëm një objekt njëbanesor ose

banesë në pjesë të posaçme të ndërtesës në të cilën jetojnë. Pranë banesës në të cilën jetojnë një ose më shumë parcela kadastrale fizike të lidhura me sipërfaqe të përgjithshme jo më të madhe se 300 m² në qytetin e Shkupit ose 500 m² në komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht një ose më shumë parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme kadastrale jo më të madhe se 5000 m² në zona rurale. Për më tepër ata mund të kenë të regjistruar vetëm një mjet motorik vëllimi i motorit i të cilit nuk është mbi 1 200 centimetër kub.

- Kërkesa është e justifikuar.

Aprovimi i ndihmës juridike dytësore pa kontrolluar gjendjen financiare

Ndihma juridike dytësore do të aprovohet pa përcaktuar gjendjen financiare në rastet e mëposhtme:

- Kërkuari është vendosur në një familje akomoduese, njësi banesore për jetesë të organizuar me mbështetje ose në një ent për mbrojtje sociale, me aktvendim të Qendrës për punë sociale (në tekstin e mëtejshëm: rrethana të veçanta),
- kërkuari duhet të iniciohet dhe përfaqësohet në një procedurë për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje para gjykatës kompetente, ose
- kërkuari për shkak të një fatkeqësie natyrore, forcë madhore ose rrethanash të tjera që janë përtej kontrollit të tij e gjen veten në një situatë financiare që e pengon atë të sigurojë në mënyrë të pavarur mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.

Kush vendos për aprovimin e ndihmës juridike dytësore?

Ndihma juridike dytësore aprovohet nga zyrtarë të autorizuar në zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë në bazë të kërkesës të paraqitur dhe kontrollit të përbushjes së kushteve.